



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 2270/prot.
3

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.413, datë.27.05.1998.

SHOQËRISË “FLORIDA” SH.P.K
Lagjia “28 Gushti”, Hotel “Shkëlzeni”, Zyra 109, Bajram Curri.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Florida” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.413, datë 27.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Qafë Prushi 5”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së në përgjigje të kërkesës tuaj, me shkresën nr.1440/3, datë 28.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2270/2 datë 01.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr. 413 datë 27.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Qafe Prushi 5”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Kërkesa juaj është për mbylljen e aktiviteti minerar në objektin fjalë, për të cilin shoqëria juaj zotëronte leje minerare nr.413, datë 27.05.1998 dhe bazohet në nenin 47, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ku thuhet:

“ Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin minerar, revokohet edhe:

a) me kërkesë të zotëruesit, kur ai ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes minerare;”

Afati i vlefshmërisë së lejes është 20 vite, që ka përfunduar me datë 26.05.2018 dhe nga ana juaj nuk është bërë kërkesë për zgjatjen e këtij afati.

Në propozimin për revokim të AKBN-së thuhet se shoqëria juaj ka ndjekur gjithë procedurat dhe ka shlyer të gjitha detyrimet për mbylljen e aktivitetit minerar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.413, datë 27.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Qafe Prushi 5”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.413, datë 27.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Qafë Prushi 5”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

